

KËRKIME GJUHËSORE

Anila OMARI

FILOLOGJIA E TEKSTEVE TË VJETRA SHQIPE DHE VENDI I SAJ NË PROGRAMET UNIVERSITARE

Në fillim të viteve '60 të shekullit të kaluar, prof. Selman Riza ideoi dhe realizoi një seminar gjuhësor për pesë autorët më të vjetër të shqipes. Që me themelimin e Universitetit të Tiranës në Fakultetin e Filologjisë zhvillohej kursi universitar “Histori e gjuhës së shkruar shqipe”, nga prof. Shaban Demiraj, ku shpjegoheshin karakteristikat e gjuhës së këtyre veprave dhe nëpërmjet tyre ndiqej evoluimi i shqipes së shkruar.¹ Profesor Riza e kishte ndier nevojën e aftësimit të studentëve në leximin e veprave të autorëve të vjetër në mënyrë që kursi të zhvillohej si duhej. Në atë kohë nuk kishte në qarkullim botime të autorëve të vjetër të shqipes. Vetë “Meshari” i Gjon Buzukut i përgatitur në botim kritik nga Eqrem Çabej, ndonëse ishte përfunduar, ishte ende në kërkim të një shtypshkronje të përshtatshme për botimin e tij. Me propozim të S. Rizës katedra e gjuhës shqipe e Fakultetit të Historisë e Filologjisë vendosi krijimin e seminarit, i cili do të ishte i detyrueshëm për studentët e kursit III të degës të gjuhës dhe letërsisë shqipe. Për qëllimet e seminarit Riza hartoi një tekst universitar të quajtur “Pesë autorët më të vjetër të gjuhës shqipe. Krestomati thjeshtë gjuhësore”, botuar në vitin 1961 nga Fakulteti i Historisë dhe i Filologjisë në formë dispense. Teksti përbëhej nga dy pjesë: e para ishte një “Hyrje mbi veçoritë grafiko-ortografike dhe gjuhësore” të secilit prej autorëve të vjetër, duke filluar kronologjikisht me Gjon Buzukun, të cilit i kushton një vend mjaft të gjerë në krahasim me autorët pasardhës: Lekë Matrëngën, Pjetër Budin, Frang Bardhin e Pjetër Bogdanin. Pjesa e dytë ishte “Krestomatia thjeshtë gjuhësore” ose një antologji me pjesë leximi nga këta autorë. Qëllimi ishte që studentët të mund të lexonin tekstet e vjetra në grafinë dhe ortografinë origjinale, në mungesë të botimeve origjinale ose anastatike. Për këtë arsye ai ndërmoi një riprodhim besnik – në terma filologjikë riprodhim diplomatik – të copave të zgjedhura në krestomaci. Prof. Emil Lafe dëshmon për punën e mundimshme të Rizës, që në mungesë të makinave fotokopjuese asokohe bëhej me dorë dhe shtypej me makinë shkrimi, duke shpikur shenja të veçanta ose kombinime shenjash të përshtatshme për makinën e shkrimit, si zëvendësuese të grafemave të veçanta të teksteve të vjetra.² Seminari i autorëve të vjetër vijoi deri në vitin 1967, kur u ndërpre për shkak të largimit nga universiteti të prof. Selman Rizës, që përkoi edhe me fillimin e luftës kundër fesë, gjatë së cilës u ndalua edhe përhapja e lirë e botimit kritik të “Mesharit” nga Çabej, i porsadalë nga shtypi në vitin 1968.

¹ Emil Lafe, “Selman Riza – themelues i seminarit për autorët e vjetër të gjuhës shqipe” në *Studime albanologjike*, revistë shkencore e Fakultetit të Historisë e Filologjisë, Universiteti i Tiranës, Tiranë 2009, f. 24.

² Po ai, po aty.

Duhet thënë se botimi kritik i tekstit më të vjetër shqip, 'Mesharit' të Gjon Buzukut, shënoi një pikë kthese në filologjinë tekstuale shqipe dhe në vetë studimet historike të gjuhës shqipe. Deri në atë kohë botimet e autorëve të vjetër të shqipes, përveç se të pakta dhe fragmentare, kishin karakter kryesisht popullor. Ndonjëherë ato dukeshin më tepër si përshtatje në gegërishten shkodrane të kohës. Mund të përmendim këtu botimet e pjesëshme të 'Mesharit' nga Justin Rrota në "Hylli i Dritës" në vitet '30, botimin e "Çetës së Profetëve" të Pjetër Bogdanit nga Mark Harapi (1943), botimin e "Jetës së Shën Mërisë" nga pjesa e dytë e veprës së Bogdanit nga Ndre Mjeda (1930) me kërkesa filologjike më të larta, e ndonjë fragment tjetër. Botimi i parë i plotë kritik i 'Mesharit' të Buzukut doli në Vatikan në vitin 1958 përgatitur nga studiuesi shqiptar me banim në Itali, Namik Ressuli. Krahas anëve pozitive, ky botim kishte të metën që disa çështje problematike të grafisë së Buzukut i la pa interpretim, duke ofruar herë-herë modelin e një botimi diplomatik të tekstit. Vetë dy parimet nga të cilat ai u nis: nga njëra anë riprodhimi sa më besnikërisht i gjuhës së Buzukut, në alfabetin e sotëm shqip, dhe nga ana tjetër dhënia e një imazhi të saktë të veçorive drejtshkrimore të Buzukut³, në thelb janë kontradiktore. Një botim kritik kërkon në radhë të parë interpretimin e realitetit gjuhësor që fshihet prapa shenjave grafike, ndërsa veçoritë grafiko-ortografike i nënshtrohen studimit dhe interpretimit, në funksion të paraqitjes sa më besnike të atij që në filologji quhet vullneti i autorit.

Botimi kritik i Çabejt, përkundrazi, bënte një dallim të qartë parimor midis dy mënyrave të botimit të një teksti të vjetër. Për këtë qëllim ai e paraqiti tekstin e Buzukut në dy vëllime, nga të cilët i pari përmbante hyrjen studimore dhe botimin diplomatik ose të ashtuquajturin transliterim, ndërsa i dyti faksimilen e origjinalit dhe botimin kritik ose "transkribimin fonetik". I pari ruante veçoritë grafiko-ortografike të origjinalit, madje edhe gabimet e shtypit, të cilat vetëm sinjalizoheshin në fusnota, ndërsa i dyti, më i rëndësishmi, synonte të rindërtonte sa më besnikërisht mënyrën se si vetë autori ka shqiptuar ose ka dashur të shqiptojë gjuha që shkruante⁴, duke u përpjekur të ndreqë edhe gabimet e shtypit.

Mbas viteve '90 u shtrua përsëri kërkesa për botimin e teksteve të vjetra shqipe, në kuadrin e botimit të trashëgimisë sonë kulturore. Puna filologjike me tekstet u kurorëzua me daljen në dritë të një vargu botimesh kritike, si ai i veprës së Pjetër Bogdanit "Cuneus Prophetarum" nga A. Omari në vitin 2005, i "Dictionarium latino-epiroticum" i Frang Bardhit nga B. Demiraj në vitin 2008, dhe i "Doktrinës së kërshen" të Gjon Nikollë Kazazit po nga ky autor në 2006, i veprës së Lekë Matrëngës nga Matteo Mandalà në 2004 dhe së fundi botimi i fjalorit dorëshkrim italisht-shqip të F. M. Da Lecces nga G. Gurga në 2009. Veprat e Pjetër Budit kishin dalë që në mes të viteve '80 në botimin kritik të G. Svanes, shoqëruar nga konkordancat elektronike përkatëse në 12 vëllime. Këto botime

³ N. Ressuli, *Il "Messale" di Giovanni Buzuku, Riproduzione e trascrizione*. Città del Vaticano, Biblioteca Apostolica Vaticana, 1958, "Prefazione", f. VIII.

⁴ E. Çabej, "Meshari" i Gjon Buzukut (1555), Tiranë, 1968, "Hyrje", f. 62.

FILOLOGJIA E TEKSTEVE TË VJETRA SHQIPE DHE VENDI I SAJ NË PROGRAMET UNIVERSITARE

plotësojnë kërkesat e nevojshme për t'u konsideruar botime kritike, pasi përmbajnë elementet përbërës të një botimi kritik. Përpunimi filologjik i tekstit të Buzukut nga Eqrem Çabej, me metodën shkencore që zbatoi, kishte krijuar një model ekdotik të vlefshëm për filologjinë tekstuale shqipe. Modeli i Çabejt krijoi një shkollë për botimet kritike të teksteve të vjetra shqipe. Sipas këtij modeli botimet e mëpasme të autorëve të vjetër përmbajnë domosdoshmërisht hyrjen studimore, e cila zakonisht artikulohet në disa problematika: së pari, aty pasqyrohet puna paraprake për botimin tekstologjik, që ka të bëjë me kërkimet rreth historisë së tekstit, studimet për rrethanat e hartimit të veprës si premisa për qëllimin e shtypjes së saj, hulumtime rreth jetës, veprimtarisë dhe personalitetit të autorit në funksion të të kuptuarit të tekstit dhe interpretimit filologjik të tij; së dyti, parashtrihen metodat ekdotike dhe kriteret e zbatuara për botimin kritik. Vihet re që këto kriteret janë të argumentuara gjuhësisht me mbështetjen e të dhënave që ofrojnë dialektet e sotme të shqipes, të projektuara historikisht në fazën e zhvillimit gjuhësor që përfaqëson gjuha e tekstit në shqyrtim, me mbështetje në krahasimet me autorët e tjerë pak a shumë bashkëkohas të të njëjtit areal gjeografik, e në të dhënat gjuhësore e statistikore që jep vetë teksti origjinal. Nëpërmjet kësaj procedure botimet e sotme kritike të teksteve të vjetra shqipe synojnë të rindërtojnë një tekst sa më pranë atij që ka dashur vërtet të shprehë autori i tij, duke iu afruar gjuhës së autorit me karakteristikat e tij individuale apo, më gjerë, të bashkëkohasve të tij.

Botimet e sotme kritike sjellin risi në zgjedhjet konkrete grafike të problemeve grafike-ortografike që paraqesin tekstet e vjetra shqipe. Në bazë të karakteristikave të ngjashme që kanë tekstet e arealit kulturor-fetar të Veriut, botimet kritike të tyre natyrisht përmbajnë zgjidhje të njëjta ose të përafërta të mjaft problemeve që paraqet grafia e tyre. Disa nga kriteret gjuhësore e konvencionet grafike të përdorura nga Çabej në zgjidhjen e çështjeve të vështira të grafisë së Buzukut janë të vlefshme edhe për autorët e tjerë të të njëjtit areal verior.

Një tipar tjetër i përbashkët i botimeve të sotme filologjike të teksteve të vjetra shqipe, që u jep atyre karakter shkencor, është dokumentimi në aparatin kritik i ndërhyrjeve të veçanta rregulluese të botuesve kritikë ndaj tekstit origjinal, si dhe shënimet shpjeguese me natyrë filologjike rreth gjuhës së tekstit e grafisë së tij. Në këtë mënyrë puna editoriale është e dukshme dhe e hapur për përmirësime të mëtejshme.

Për riprodhimin e teksteve përdoren metodat e rekomanduara në këto lloj botimesh, sidomos kur është fjala për tekste të vjetra, siç është riprodhimi anastatik, krahas botimit të tekstit të rindërtuar në mënyrë kritike, dhe ndonjëherë edhe riprodhimi diplomatik, si në botimin e 'Mesharit' të Buzukut nga Çabej, botimin e 'Dictionarium latino-epiroticum' të Frang Bardhit e të 'Doktrinës së Kërshten' të Gjon Kazazit nga B. Demiraj. Ballafaqimi me origjinalin në faksimile e bën botimin kritik transparent ndaj lexuesit e studiuesit, i cili mund të konstatojë ndryshimet e sjella nga botuesi kritik dhe t'i vlerësojë ato.

Një prije bashkëkohore në botimet e teksteve të vjetra shqipe është zbatimi i teknikave të reja kompjuterike në përpunimin e tyre. I pari që zbatoi një teknikë të tillë të përparuar që në vitet 1985-'86 ishte G. Svane, i cili botimin e veprave të Budit e shoqëroi me konkordancat elektronike në 12 vëllime të krejt teksteve të tyre. Më pas edhe botimet e tjera janë pajisur me konkordanca të lematizuara. Kjo është një bazë e mirë për hartimin e një fjalori historik të shqipes, që mungon deri sot.

Me përfshirjen e Universiteteve të Shqipërisë në sistemin universitar të Bolonjës, u krijuan mundësitë për futjen e lëndëve të reja në programe. Fakulteti i Historisë dhe i Filologjisë kishte bërë që më parë përmirësime dhe modernizime të programeve. Në vitin 1998 u rihap Seminari për autorët e vjetër të shqipes, nga prof. Emil Lafe. Ndërkohë, ishte bërë e nevojshme edhe pajisja e studentëve me njohuri të filologjisë tekstuale bashkëkohore, për përgatitjen e botuesve të kualifikuar të trashëgimisë sonë letrare. Në këtë vështrim, në programet tona universitare ka pasur zbrazëti, që përkonte me një lloj prapambetjeje në fushën e filologjisë tekstuale në Shqipëri. Botimet akademike të trashëgimisë letrare shqipe përmbanin disa kritere botimi, por nuk mund të konsideroheshin botime të mirëfillta kritike, pasi u mungonte argumentimi shkencor në zgjidhjet e ndryshme editoriale e ekdotike, si edhe transparencja e duhur për gjykimin nga lexuesi, pra ato që në një botim kritik përbëjnë hyrjen ose prolegomenat dhe aparatin kritik. Për të metat në botimet tona akademike mund të citojmë prof. Francesco Altamarin, i cili, duke u nisur nga kërkesa fillestare për të përpiluar konkordancën elektronike të poemës “Bagëti e Bujqësia” të Naim Frashërit, u detyrua të ndërmerre më parë punën për një botim kritik filologjikisht korrekt të veprës, pasi, në morinë e botimeve të ndryshme të veprës, nuk gjeti një që të ishte më i besueshëm. Në botimet më të reja vuri re ndërhyrje të pajustikuara të botuesve. Më keq paraqitej gjendja në tekstet shkollore, në të cilat pjesët nga tradita letrare ndodhte që përshtateshin në një shqipe moderne. Sot, në kontekstin e lirisë së shtypit e të shtimit progresiv të numrit të shtëpive botuese, një problem të madh besueshmërie kanë botimet e shumta të trashëgimisë sonë letrare nga botues pa përgatitjen e nevojshme filologjike.

Në këto rrethana, u gjykua e nevojshme nga këshilli shkencor i Fakultetit të Filologjisë të shtohet lënda e filologjisë në programet e gjuhës dhe të letërsisë shqipe, e cila filloi të aplikohet që nga viti 2009, në nivelin master të degës së gjuhës shqipe.

Programi i lëndës së re u mendua si një ndërthurje e njohurive bazë rreth filologjisë së teksteve me zbatimin e tyre në tekstet e vjetra shqipe. Në këtë mënyrë lënda paraqitej si një rimarrje e seminarit të autorëve të vjetër, por mbi një bazë të re konceptuale.

Që në përkufizimet e para të termave duheshin sqaruar disa koncepte themelore të fushës, për të shmangur edhe ekuivoket që mund të vinin nga përmbajtjet e ndryshme që nënkuptonin termat. Termi filologji tek ne përfshinte kuptimin e gjerë të këtij nocioni, pra disiplinën që shqyrton tekstet dhe dokumentet gjuhësore dhe letrare të një kulture e qytetërimi të caktuar dhe përmes

FILOLOGJIA E TEKSTEVE TË VJETRA SHQIPE DHE VENDI I SAJ NË
PROGRAMET UNIVERSITARE

tyre studion gjuhët e këtyre kulturave në aspektin diakronik dhe sinkronik. Në Evropën perëndimore termi filologji përkufizohet në dy kuptime, në kuptimin e gjerë, të cilin e përmendëm, dhe në një kuptim të ngushtë, si shkenca dhe teknika që ka si synim të rindërtojë një tekst në formën e tij origjinale apo sa më afër origjinalit, duke e çliruar nga gabimet e prekjet e mëvonshme, ta interpretojë atë, të saktësojë autorin (kur ka dyshime për të), kohën e krijimit dhe mjedisin kulturor. Me fjalë të tjera ky është edhe kuptimi i filologjisë si kritikë teksti ose si teknika e restaurimit të teksteve, qoftë të lashta apo të reja, me synim gjetjen e atij që quhet “vullneti i autorit” apo forma e shprehjes që ka dashur të japë autori i tekstit. Në Shqipëri kjo disiplinë e rindërtimit të tekstit më parë quhej *tekstologji*, sipas një termi të huazuar nga rusishtja.

Edhe termat që shënonin metodat e botimit të një teksti, sidomos të vjetër, ishin nga rusishtja. Me *transliterim*, fjala vjen, në botimin e ‘Mesharit’ të Buzukut nga Çabej, kuptohej riprodhimi i tekstit të origjinalit duke respektuar të gjitha karakteristikat e jashtme të tij, si grafatë origjinale, shenjat grafike të veçanta, gabimet e shtypit, majuskulat e minuskulat, sistemin e pikësimit etj., pra ai që quhet sot *botim diplomatik*. Ndërsa *transkribimi fonetik*, sipas Çabejt, ishte rindërtimi i tekstit sa më besnikërisht sipas mënyrës së shqiptimit të gjuhës së autorit, pra Gjon Buzukut, duke interpretuar shenjat grafike sipas përmbajtjes së tyre fonetike në projeksion historik, dmth. në shqipen e shek. XVI. Njëkohësisht puna ekdotike e Çabejt përmbante edhe ndreqjen e gabimeve të shtypit, duke mos qëndruar thjesht në interpretim, por duke rindërtuar tekstin në mënyrë kritike. Në termat e filologjisë perëndimore kjo metodë riprodhimi quhet *botim kritik*.

Lënda e re kërkon adoptimin e termave përkatëse, që tek ne nuk kanë qenë të njohura. Kështu, leksionet e para, përveç një historiku të shkurtër të filologjisë si shkencë, u kushtohen shpjegimit të termave e koncepteve themelore me të cilat operon filologjia tekstuale, si: *teksti*, *autografi*, *origjinali*, *variantet* (e autorit ose të redaktorit), *leximi*, *dëshmitari i një teksti*, *gabimi*, *arketipi*, *kodiku*, *inkunabula*, *kodiku më i mirë* etj. Një pjesë e mirë e termave të filologjisë janë në latinisht, pasi dihet që filologjia është zhvilluar në një kohë kur latinishtja ishte gjuha e kulturës për gjithë botën e qytetëruar. Në këtë rast ato u jepen studentëve në latinisht, duke dhënë edhe shpjegimin shqip. Disa nga termat latine më të rëndësishme të filologjisë janë në radhë të parë ato që kanë të bëjnë me veprimet e filologut për botimin korrekt të një teksti, si: *recensio* ose regjistrimi i të gjithë dëshmitarëve që ekzistojnë në transmetimin e një teksti, *collatio* ose konfrontimi fjalë për fjalë i dëshmitarëve, *eliminatio codicum descriptorum* “eliminimi i dëshmitarëve të kopjuar”, *stemma codicum* ose pema gjenealogjike e dorëshkrimeve ose e shtypeve, *restitutio textus* ose rindërtimi i tekstit sa më afër origjinalit, *emendatio* ose korrigjimi i gabimeve nëpërmjet konjekturës (*divinatio*), *lectio difficilior* ose leximi më i vështirë si kriter për leximin e drejtë ndaj *lectio faciliior* ose banalizimit që kanë zakon të bëjnë kopistët, *usus scribendi* ose shprehitë stilistike e gramatikore të autorit.

Pjesa kryesore e programit përqendrohet në tekstet e vjetra shqipe, që nga dëshmitë e para shkrimore fragmentare e deri në veprat e plota të pesë autorëve kryesorë të shqipes së vjetër, nga të cilët katër janë autorët katolikë të Veriut dhe i pesti Lekë Matrënga si përfaqësues i qarkut kulturor-fetar të jugut ortodoks. Synimi kryesor i kursit është zbërthimi i kodeve grafike dhe i veçorive ortografike të secilit autor si dhe i veçorive gjuhësore të tyre, duke i konkretizuar këto në leximin e pjesëve nga tekstet. Krahas kësaj jepen edhe rregulla bazë e sugjerime për transkriptimin e teksteve të vjetra si dhe diskutohen çështjet problematike dhe zgjidhjet e diskutueshme.

Kjo lëndë jepet tashmë prej tre vjetësh në Fakultetin e Historisë e të Filologjisë, dhe prej një viti edhe në masterin e shkollës doktorale të Instituti të Gjuhësisë e të Letërsisë pranë Qendrës së Studimeve Albanologjike në Tiranë.

BIBLIOGRAFI

- ALTIMARI, Francesco (ed.), *Naim Frashëri. Bagëti' e Bujqësia (I pascoli e i campi)*, Introduzione, edizione critica, traduzione italiana e concordanza a cura di F. Altimari. Centro Editoriale Librario Università degli Studi della Calabria, Rende, 1994.
- ÇABEJ Eqrem, *Meshari" i Gjon Buzukut (1555)*. Botim kritik, Pjesa e parë – Hyrje dhe transliterim, Pjesa e dytë - Faksimile dhe transkribim fonetik, Tiranë, 1968.
- DEMIRAJ Bardhyl, *Dictionarium latino-epiroticum (Romae 1635) per R.D. Franciscum Blanchum*, Botime françeskane, Shkodër, 2008.
- DEMIRAJ Bardhyl, *Gjon Kazazi dhe "Doktrina" e tij*, ASHAK, Prishtinë, 2006.
- DEMIRAJ, Shaban, *Historia e gjuhës së shkruar shqipe*, Universiteti i Prishtinës, Prishtinë, 1970. (Botuar sipas skripteve të Universitetit Shtetëror të Tiranës, 1967).
- GURGA, Gëzim (ed.), *Francesco Maria da Lecce, Dittionario Italiano-Albanese (1702)*, botim kritik i dorëshkrimit dhe fjalësi shqip përg. nga G. Gurga, Botime Franceskane, Shkodër, 2009.
- HARAPI Mark, (përg.), "Emzot Pjetër Bogdani 'Cuneus Prophetarum' a se Çeta e Profetve, qitë n'alfabetin e soçëm e kthiellue me vrojtime prej M. H.", Pjesa I, botuar në seri në *Lajmtari i Zëmrës së Krishtit*, Shkodër, 1940-1943.
- LAFE, Emil, "Selman Riza – themelues i seminarit për autorët e vjetër të gjuhës shqipe" në *Studime albanologjike*, revistë shkencore e Fakultetit të Historisë e Filologjisë, Universiteti i Tiranës, Tiranë 2009.
- MANDALÀ Matteo (ed.), *Luca Matranga. E mbsuame e krështerë*, Edizione critica dei testi manoscritti e a stampa (1592), S. Sciascia Editore, Caltanissetta, 2004.
- MJEDA Ndre, Jeta e së lumes Virgjin Mri, nxjerrun prej veperës "Cuneus Prophetarum" së Simzot Pjetër Bogdanit Argjipeshkvit së Shkupsë, përshkrue e botue prej D. Ndre Mjedsë, Shkodër, 1930.

FILOLOGJIA E TEKSTEVE TË VJETRA SHQIPE DHE VENDI I SAJ NË
PROGRAMET UNIVERSITARE

- OMARI Anila (ed.), *Pjetër Bogdani. Cuneus Prophetarum*, botim kritik, ASHSH IGJL, Mësonjëtorja, Tiranë, 2005.
- RESSULI, Namik, Il "Messale" di Giovanni Buzuku, riproduzione e trascrizione, Città del Vaticano, 1958.
- RIZA Selman, "Pesë autorët më të vjetër të shqipes. Krestomati thjesht gjuhësore", në: *Vepra 1*, ASHAK, Prishtinë, 1996.
- SVANE Gunnar (ed.), *Peter Budi, Dottrina Christiana (1618)*. With a transcription into modern orthography and a concordance prepared by Gunnar Svane. Institut for Lingvistik, Aarhus Universitet, Århus, 1985.
- SVANE Gunnar (ed.), *Peter Budi, Rituale Romanum (1621)*. With a transcription into modern orthography and a concordance prepared by Gunnar Svane. Institut for Lingvistik, Aarhus Universitet, Århus, 1986.
- SVANE Gunnar (ed.), *Peter Budi, Speculum Confessionis (1621)*, With a transcription into modern orthography and a concordance prepared by Gunnar Svane. Institut for Lingvistik, Aarhus Universitet, Århus, 1986.